



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 65 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Autorizimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së për Nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

- I. Autorizohet Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së, që të nënshkruaj Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), për angazhimin e zyrtarit të përkthimit në gjuhën serbe për nevojat e KQZ-së.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADOMIQI

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Znj.Qendresa Haliti**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj.Arjeta Abazi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Qendresa Haliti dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 19.12.2024, Nr.07/7-2238/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Arjeta Abazi, e cila ka dhënë dorëheqje për arsye se, është kandidatë për deputete për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 09 shkurt 2025. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirënditur është znj.Qendresa Haliti. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z.Fatmir Gashi**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z.Qendrim Softolli.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Fatmir Gashi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 19.12.2024, Nr.07/7-2239/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Qendrim Softolli, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye se, është kandidatë për deputetet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 09 shkurt 2025. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Fatmir Gashi. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 2 dhe nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Ndryshimit të Lokacionit të QKN-së në Fushë-Kosovë

- I. Miratohet ndryshim i lokacionit të QKN në Fushë Kosovë, Palestra e Sporteve , Rr. Aziz Zhilivoda, Nr. 33, hapësira 600 metra katrore, i miratuar më datën 11.09.2024, Nr.01/1618/2024, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Lokacioni i QKN në Fushë Kosovë caktohet : Salla e Edukatës Fizike të SH.F.M.U. "Daut Bogujevci" rr. Tahir Zemaj me hapësirë 450 metra katror.
- III. Kërkesa për ndërrimin e QKN si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 2 dhe nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Ndryshimit të Lokacionit të QKN-së në Obiliq

- I. Miratohet ndryshim i lokacionit të QKN në Obiliq, Palestra e Sporteve "Adem Jashari" në rrugën Adem Jashari, në hapësirën 250-350 metra katrore, i miratuar më datën 11.09.2024, Nr.01/1618/2024, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Lokacioni i QKN në Obiliq caktohet : Salla sportit Gjinnazi "17 Shkurti" në rrugën "Rasim Hashani", në hapësirë 924 m2 .
- III. Kërkesa për ndërrimin e QKN si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesuesi KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Ndryshim/Plotësimit të Dokumentit “Specifikat për Ngjyrën Matrikuluese”

- I. Miratohet ndryshim/plotësimit i Dokumentit specifikat teknike për “Ngjyrën Matrikuluese”, i miratuar më 24.06.2024, Nr.01/975/2024, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Dokumenti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 23.12.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Ndryshim/Plotësimit të Dokumentit Specifikat Teknike “Transporti i Materialit Sensitiv dhe jo Sensitiv”

- I. Miratohet ndryshim/plotësimit i dokumentit specifikat teknike “Transporti i Materialit Sensitiv dhe jo Sensitiv”, i miratuar më 11.09.2024, Nr.01/1619/2024, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Dokumenti i ndryshuar/plotësuar si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ

